



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

STANDARDI I PROFESIONIT

Asistent i punëtorit të kulturave bujqësore – Prodhimi i perimeve (Arsimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta-FNV)

Sektori: Bujqësi

Kodi: ISCO08 9211

Data e miratimit:

Ky standard i profesionit është zhvilluar në kuadër të Projektit ALLED “Harmonizimi i Arsimit me Kërkesa të Tregut të Punës (Kosovë)”

Ekipi i zhvillimit:

Udhëheqësi i ekipit:

Josip Juračak, Phd, ekspert në fushën e bujqësisë, Kroaci

Përbërja e ekipit:

Qëndresa Qelaj, SHML “Abdyl Frashëri” Prishtinë

Emin Haziri, SHML “Jonuz Zejnullahu” Viti

Shani Cena, SHML “Selajdin Mullaabazi - Mici” Rahovec

Shpresa Hadri, SHML “Kadri Kusari” Gjakovë

Afrim Shabani, SHML “Kadri Kusari” Gjakovë

Shqipe Dreshaj, SHML “Abdyl Frashëri” Prishtinë

Fatos Lajqi, SHML “Ali Hadri” Pejë

Data e miratimit:`

Valide: Për periudhën prej 5 vite

Kodi i profesionit: ISCO08 9211 Punëtor i kulturave bujqësore

Profesioni: Asistent i punëtorit të kulturave bujqësore – Prodhimi i perimeve (Arsimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta-FNV)

Përshkrimi i profesionit

Asistent i punëtorit të kulturave bujqësore – prodhimi i perimeve (Arsimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta-FNV)

Punëtori i perimeve bujqësore kryen aktivitete të thejshta dhe rutinore në prodhimin e llojeve të ndryshme të perimeve në ambiente të hapura. Detyrat që kryen zakonisht përfshijnë: kryen aktivitete në përgatitjen e tokës, mbjelljen, mirëmbajtjen e kulturave duke punuar tokën me vegla të dorës, heqja e barërave të këqija dhe duke u kujdesur për tokën duke përdorur vegla të dorës, vjeljen, mbledhja e kulturave, inspektimi, gradimi, selektimi, grumbullon dhe paketon produktet në kontejnerë, ngarkimi, shkarkimi dhe rregullimi i furnizimit dhe produkteve.

Orari i punës varet nga kërkesat e procesit të prodhimit. Në shumë operacione, kushtet e punës kërkojnë përdorimin e masave dhe mënyrave të sigurisë në punë si dhe uniformës mbrojtëse dhe paisje tjera në rast të kushteve të papërshtatshme atmosferike.

Për disa nga aktivitetet është e nevojshme forca dhe qëndrueshmëria fizike.

Profesioni: Asistent i punëtorit të kulturave bujqësore – prodhimi i perimeve (Arsimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta-FNV)

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Përgatitë vendin e punës	Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e veglave të zakonshme të punës dhe material si dhe të ndërmarre masat e nevojshme për siguri të punës. Ky funksion përfshinë poashtu edhe marrjen e instruksioneve të përditshme nga mbikëqyrësi ose nga plani i përditshëm në formë të shkruar.
2	Organizon punën	Ky funksion ka të bëjë me planifikimin dhe organizimin e paisjeve të punës në fushë, me qëllim të realizimit të punës efektive.
3	Kryen aktivitete operative në procesin e rritjes së perimeve	Ky funksion përfshien këto aktivitete: përgatitja e tokës duke përdorur vegla të dorës, mbjellja e perimeve me dorë ose duke përdorur vegla të dorës, heqja e barërave të këqija ose forma tjera të mirëmbajtjes së perimeve duke përdorur vegla të dorës ose duart.
4	Vjelë dhe merret me produktet	Ky funksion ka të bëjë me aktivitetet e mbledhjes dhe vjeljes së perimeve, si dhe me trajtimin e kulturave për deponim.
5	Mban një ambient të punës të sigurtë dhe të pastër	Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e higjienës personale dhe rregullat e sigurisë në punë, si dhe me aplikimin e praktikave të mbrojtjes së ambientit gjatë hedhjes së mbeturinave.

Funksioni 1: Përgatitë vendin e punës

Ky funksion ka të bëjë me marrjen e instruksioneve të përditshme nga mbikëqyrësi ose nga plani i përditshëm në formë të shkruar. Poashtu përfshien edhe përgatitjen veglave të nevojshme të punës dhe materialit si dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për siguri të punës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Merr instruksionet e punës	Merr dhe zbaton saktë instruksionet nga mbikëqyrësi. Lexon instruksionet e thjeshta në bazë të orëve ose edhe ditore dhe i implementon si duhet.	Leximi i planeve të thejshta të punës;	Përdorimi i veglave të dorës; Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja); Leximi i instruksioneve të thjeshta në gjuhë amëtare; Aftësi të punojë në përputhje me masat e sigurisë në punë;	Komunikim ndërpersonal; I hapur për sugjerime; Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike; Qëndrueshmëri fizike; Tolerancë në orar fleksibil të punës;
Zgjedh dhe kontrollon veglat e punës	Zgjedh veglat e duhura të punës. Kontrollon vërtetësinë dhe kushtet e veglave të punës. Përgatitë materialin e punës duke u bazuar në llojin dhe cilësinë e kërkuar.	Llojet e aktiviteteve në prodhimin e perimeve; Llojet themelore në prodhimin e materialeve; Llojet e veglave të punës;		
Ndjek, nën mbikëqyrje, rregullat e higjienës dhe masat e sigurisë në punë	Mirëmban nivelin e kërkuar të higjienës. Vesh rrobat mbrojtëse personale bazuar në instruksionet e dhëna. Zbaton masat e sigurisë në punë bazuar në instruksionet e dhëna.	Rrobat mbrojtëse si dhe paisje tjera personale mbrojtëse në punë; Bazat e aritmetikës;		

Kushtet e kërkuara për realizimin e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati do të duhej të ketë në dispozicion dhe të jetë në gjendje të përdorë këto vegla: uniforma e punës, veglat e dorës si dhe instruksionet e punës në formë të shkruar. Poashtu edhe mënyrat e transportit do të duhej të sigurohen, në rast të punës në fushë.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me gojë i përkrahur edhe me testin në formë të shkruar me qëllim të demonstrimit të të kuptuarit të koncepteve themelore.

Kandidati i nënshtrohet testimit praktik në fushë me qëllim të demonstrimit të njohurive të tij/ të saj praktike si dhe të shkathtësive për të përdorur veglat e punës.

Funksioni 2: Planifikon dhe organizon punën

Ky funksion ka të bëjë me organizimin e materialeve të prodhimit, paisjeve si dhe materialit ndihmës në fushë. Ndarja e duhur e materialit është e rëndësishme për të punuar më me efikasitet në sasi të mëdha të prodhimit.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Oragnizon materialin prodhues	Cakton inputet e prodhimit në fushë për efikasitet më të lartë në punë.	Llojet e materialeve prodhuese (inputet) në prodhimin e perimeve; Llojet e materialeve ndihmëse për kujdesin ndaj kulturave;	Vlerësimi i distancës; Vlerësimi i peshës;	Komunikim ndërpersonal; I hapur për sugjerime;
Organizon materialin ndihmës	Vendosë konteinerët, kutitë, thasët dhe materialet e ngjajshme në hapësirat e duhura në fushë. Mbledh mbetjet e prodhimeve dhe i vendosë ato në mënyrë racionale.	Llojet e knotejnerëve dhe mënyra tjera të ambalazhimit të cilat përdoren për grumbullimin dhe transportin e produkteve dhe mbetjeve; Format themelore gjeometrike; Bazat e aritmetikës;	Komunikimi me mbikëqyrësin; Përdorimi i karrocës së dorës, qerres dhe mjete të ngjajshme të transportit; Kalkulime të thjeshta;	Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike; Qëndrueshmëri fizike; Tolerancë në orar fleksibil të punës; Racional;

Kushtet e kërkuara për realizimin e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati do të duhej të ketë në dispozicion dhe të jetë në gjendje të përdorë: ngastrën për mbjellje, materialin për mbjellje, uniformën e punës dhe mjetet e sigurisë personale kur të jetë e nevojshme, lloje të ndryshme të mjeteve dhe materialeve prodhuese, mjetet e transportit me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me gojë i përkrahur edhe me testin në formë të shkruar me qëllim të demonstrimit të të kuptuarit të koncepteve themelore.

Kandidati i nënshtrohet testimit praktik në fushë me qëllim të demonstrimit të njohurive të tij/ të saj praktike si dhe të shkathtësive për të përdorur veglat e punës.

Funksioni 3: Kryen aktivitete operative në procesin e rritjes së perimeve

Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e tokës për mbjellje, mbjelljen, kultivimin e tokës dhe kujdesin ndaj kulturave. Aktivitetet të cilan zhvillohen në këtë funksion do të mund të kryhen me duar, duke përdorur vegla të dorës apo paisje të cilat menagjohen nga persona të kualifikuar.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Përgatitë tokën për mbjellje ose mbjellje të farave në ngastra të vogla	Lëron tokën në thellësinë e duhur dhe i jep teksturën duke përdorur veglat e dorës. Shpërndanë plehun. Formëson ngastrën e farave/ fidaneve.	Llojet e zakonshme të perimeve që rriten në rajon; Format gjeometrike;	Përdorimi i veglave të dorës për kultivimin e tokës; Aftësi për të punuar në kushte të pafavorshme; Komunikimi me mbikëqyrësin;	Komunikim ndërpersonal; Vlerësimi i distancave; I hapur për sugjerime; Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike; Qëndrueshmëri fizike; Tolerancë në orar fleksibil të punës; Racional;
Mbjell kulturat	Mbjell kulturat me kujdes nën mbikëqyrje. Mbjell fidanet me kujdes nën mbikëqyrje. Kryen aktivitetet e kërkuara pas mbjelljes.	Matjet e thjeshta (largësia, thellësia); Teknikat e përgatitjes së tokës; Veglat për përgatitjen e tokës;	Ndjekja e instruksioneve në formë të shkruar; Matja e distancave; Vëmendje ndaj detajeve;	
Mirëmbanë kulturat gjatë procesit të vegjetimit	Largon barërat e këqija nga kulturat duke përdorur vegla të dorës. Rrallon kulturat. Vendos mbështetje tek bimët dhe i lidhë ato sipas nevojës. Ujit në përputhje me instruksionet. Aplikon, nën mbikëqyrje, masat e kujdesit ndaj bimëve.	Veglat për mbjellje dhe hedhje të farave; Aritmetikë e thjeshtë; Lexon instruksionet në formë të shkruar; Bazat e ujitjes;	Vesh uniformën e punës dhe mjetet tjera të sigurisë personale; Kontrolli i sistemit të ujitjes për keqfunksionime të dukshme; Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja);	

--	--	--	--	--

Kushtet e kërkuara për realizimin e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati do të duhej të ketë në dispozicion dhe të jetë në gjendje të përdorë: ngastër për rritjen e bimëve, uniformën e punës dhe mjete tjera të sigurisë personale, lopata, gërrshërë, grabujë, shati, kazmë, sfurk, sëpatë, drapër si dhe mjete të tjera për kultimim dhe për kujdesje të bimëve.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me gojë i përkrahur edhe me testin në formë të shkruar me qëllim të demonstrimit të të kuptuarit të koncepteve themelore.

Kandidati i nënshtrohet testimit praktik në fushë me qëllim të demonstrimit të njohurive të tij/ të saj praktike si dhe të shkathtësive për të përdorur veglat e punës.

Funksioni 4: Vjelë dhe merret me produktet

Ky funksion përfshien aktivitetet që kanë të bëjnë me vjeljen dhe me aktivitetet tjera rreth kulturave pas procesit të vjeljes. Detyrat gjatë procesit të vjeljes përfshiejnë mbledhjen me dorë, vjeljen, korrijen, mbledhjen dhe kositjen e kulturave. Aktivitetet pas procesit të vjeljes përfshiejnë inspektimin, gradimin, selektimin, grumbullimin dhe ambalazhimin e produkteve në kontejnerë, ngarkimin dhe shkarkimin për qëllime të transportit dhe deponimit.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Vjelë perimet e pjekura	<p>Mbledh/ vjel me kujdes të gjitha llojet e perimeve dhe frutave.</p> <p>Inspekton produktet dhe ndanë ato të dëmtuarat.</p>	<p>Organet bimore;</p> <p>Njohja, nën mbikëqyrje, e kulturave të pjekura dhe të shëndetshme;</p>	<p>Përdorimi i veglave të dorës për mbledhje/ vjelje;</p> <p>Mbledhja nga platformat lëvizëse të vjeljes;</p>	<p>Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike;</p>
Kryen detyrat e pas vjeljes	<p>Klasifikon kulturat e vjelura dhe i vendos ato në kontejnerët korrespondues.</p> <p>Ngarkon dhe shkarkon kontejnerët me kultura për transport dhe deponim.</p> <p>Pastron hapësirën pas vjeljes dhe mirëmban si duhet nën – produktet.</p>	<p>Teknikat e mbledhjes së perimeve të ndryshme;</p> <p>Veglat për mbledhje, grumbullim dhe vjelje;</p> <p>Llojet e kontejnerëve për perime;</p> <p>Klasat kryesore;</p> <p>Mënyrat e mirëmbajtjes dhe hedhjes së nën - produkteve;</p>	<p>Aftësia për të punuar në kushte të pafavorshme;</p> <p>Vëmendje ndaj detajeve;</p> <p>Vesh uniformën e punës dhe mjetet tjera për siguri personale;</p> <p>Aritmetikë e thjeshtë (numërimi, mbledhja, zbritja);</p> <p>Komunikim me mbikëqyrësin po pati ndonjë dyshim;</p>	<p>Komunikim ndërpersonal;</p> <p>I hapur për sugjerime;</p> <p>Për disa nga aktivitetet qëndrueshmëri dhe forcë fizike;</p> <p>Tolerancë në orar fleksibil të punës;</p> <p>Racional;</p>

Kushtet e kërkuara për realizimin e funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati do të duhej të ketë në dispozicion dhe të jetë në gjendje të përdorë: parcelë eksperimentale ose komerciale për prodhim të perimeve, vegla të dorës për mbledhje dhe vjelje, konteinerë për perime, uniform e punës dhe mjete tjera për siguri personale.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me gojë i përkrahur edhe me testin në formë të shkruar me qëllim të demonstrimit të të kuptuarit të koncepteve themelore.

Kandidati i nënshtrohet testimit praktik në fushë me qëllim të demonstrimit të njohurive të tij/ të saj praktike si dhe të shkathtësive për të përdorur veglat e punës.

Funksioni 5: Mban një ambient të punës të sigurtë dhe të pastër

Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e rregullave të higjienës personale dhe të sigurisë në punë, aplikimi i rregullave të sigurisë së ushqimit, si dhe aplikimi i rregullave të mbrojtjes së ambientit gjatë hedhjes së mbeturinave.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathësitë	Shkathësitë kyçe dhe shkathësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Aplikon rregulloren e higjienës personale dhe e sigurisë në punë nën instruksione dhe mbikëqyrje	Mirëmban nivelin e kërkuar të higjienës dhe të masave të sigurisë në punë. Kujdeset për pastërtinë, sigurinë si dhe pastërtinë e paisjeve të punës.	Rreziqet e mundshme që lidhen me aktivitetet dhe veglat e zakonshme që përdoren gjatë punës; Mënyrat e mirëmbajtjes dhe hedhjes së duhur të mbejtjeve të fushave dhe të nën - produkteve;	Përdorimi i sigurtë i veglave të punës dhe materialeve; Përdorimi bazë i ndihmës së parë;	Komunikim ndërpersonal; Kushton kujdes punës në progres;
Aplikon rregulloren për siguri të ushqimit nën instruksione dhe mbikëqyrje.	Trajton me kujdes kulturat e vjelura. Kryen me saktësi dhe në afat të duhur aktivitetet e vjeles dhe ato të pas vjeljes.	Paralajmërimet dhe alarmimet themelore vizuale dhe verbale;	Njohja e llojeve të ndryshme të mbejtjeve dhe konteinerët korrespondues.	Reagim i shpejtë në rast të problemeve; Tolerancë ndaj kushteve të papërshtatshme atmosferike;
Aplikon praktikat e mbrojtjes së ambientit gjatë hedhjes së mbeturinave nën instruksione dhe mbikëqyrje	Trajton me kujdes materialet prodhuese dhe ambalazhimin e tyre në harmoni me rregullat e mbrojtjes së ambientit. Menagjon mbejtjet e fushës në atë mënyrë që të mos jetë e dëmshme për ambientin.	Masat paraprake të sigurisë përfshirë këtu edhe përdorimin e paisjeve për mbrojtje personale; Rëndësia e mbajtjes pastër të vendit të punës; Procedurat në raste të emergjencës;	Mbjajtja e nivelit të higjienës personale. Veshja e uniformës së punës dhe paisjeve mbrojtëse kur është e nevojshme. Dikton të metat në procesin e prodhimit.	Për disa nga aktivitetet qëndrueshmëri dhe forcë fizike; Tolerancë në orar fleksibil të punës; Racional;

Kushtet e kërkuara për realizimin e funksionit:

Siguria në punë i referohet mirëmbajtjes së shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës duke iu shmangur rreziqeve të mundshme. Mbrojtja e ambientit i referohet mirëmbajtjes së pastërtisë në vendin e punës. Për të kryer këtë funksion, kandidati do të duhej të ketë në dispozicion dhe të jetë në gjendje të përdorë: parcelë eksperimentale ose komerciale për prodhim të perimeve, mjetet personale higjienike dhe hapësira, uniform mbrojtëse dhe pajisje tjera shtesë, veglat për hedhjen e mbejtjeve dhe konteinerë.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me gojë i përkrahur edhe me testin në formë të shkruar me qëllim të demonstrimit të të kuptuarit të koncepteve themelore.

Kandidati i nënshtrohet testimit praktik në fushë me qëllim të demonstrimit të njohurive të tij/ të saj praktike si dhe të shkathhtësive për të përdorur veglat e punës.